REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 435/1prot. Tiranë më 21.11.2024

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 13.12.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 24.1.2022, është njoftuar vendimi nr. 479, datë 3.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, në atë kohë, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër.

Komisioneri Publik, duke vlerësuar se vendimi nr. 479, datë 3.12.2021, i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor, më datë 4.2.2022, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Komisioneri Publik, pa dashur të kalojë në përsëritje të rrethanave, fakteve dhe shkaqeve të parashtruara gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022, i qëndron dhe i vlerëson ato të plota, duke i konsideruar dhe si parashtrime për seancën e datës 13.12.2024.

Sa më sipër, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 4.2.2022, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë kumulative, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kritereve të procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, vendimi nr. 479, datë 3.12.2021, i Komisionit, nuk konsiderohet i drejtë dhe nuk duhet lënë në fuqi.

Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 2, 3, 4 dhe/ose 5, të ligjit nr. 84/2016, kërkon që, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti.*

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA